- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

---

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a. Kopje të certifikuar të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) te tre viteve te fundit, konkretisht te viteve 2017, 2018, 2019.
- b. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore per tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve, konkretisht 2017, 2018, 2019 të mos jete me vlerë më të ulët se 72,000,000 (Shtatedhjetë e dy million) leke pa tvsh.
- c. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- 1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 72,000,000 (Shtatedhjetë e dy million) leke pa tvsh.

**Ne rast se kontrata eshte kryer me ente publike:**

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Ne rast se kontrata është kryer me sektorin privat:**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listen e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Tiranë të jenë minimalisht 3 (tre) stacione shitje me pakice pasi ka shtrirje teritoriale të madhe dhe përqendrim të shumë Institucioneve, kjo vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj). Këto stacione të jenë të pajisura me Autorizim/Licencë lëshuar nga pushteti vendore, leje mjedisore të tipit C, vërtetim teknik lëshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrojtjes nga Zjarri lëshuar nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri për distributorët e shitjes me pakice.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të legjislativës Shqiptare, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive për vitin 2018 dhe 2019.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim Teknik të lëshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje Mjedisore të tipit B, të lëshuar nga QKL, Certifikate e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga M.Z.SH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese mbi 10 000 m<sup>3</sup> lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Flete analize të lëshuar nga ISHTI të cilat duhet të jenë lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.
6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:
  - Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin e pandërprerë në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Krujë, Lushnjë, Berat, Kucovë, Skrapar, Fier, Vlorë, Patos, Ballsh, Gjirokastër, Sarandë, Tepelene, Permet, Korce, Pogradec, Bilisht, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Gramsh, Librazhd, Shkoder, Koplak, Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Bulqizë, Rubik, Diber, Mirditë, Kukës, Tropoj dhe Has., me karte elektronike të personalizuar me targa të cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.



- OE duhet të paraqese hartën e vendndodhjeve të distributoreve të tij, (Pikat e karburanteve ku mund të kryhet furnizimi me karta elektronike ose tollona) në pronesi apo me qera APO NE MARREVESHJE ME TE TRETË. Pikat të jenë të shoqeruara me informacionin për pergjegjesin e pikes së karburantit dhe kontaktin. (OE i cili nuk disponon pika karburanti në të gjitha qytetet ku ushtron aktivitet AK, duhet të paraqesë kontrata qiraje apo kontrata bashkëpunimi të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin me karburant nepermjet kartave elektronike të personalizuar, dhe në tollona në formë biletash sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën e elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit 2020.
- Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një nderfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike. Kjo nderfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasise së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
- Disponimi /Ekzistenca e nderfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kerkuara mesiper, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anetareve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

**Mos ofrimi i Nderfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përben kusht për skualifikim.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

### **ALBANIAN STANDARD AL ST EN 590:2013**

#### **Liquid Fuel for Vehicles -Gasoline Diesel-Requirements and Test Methods**

#### **Automotive fuels-Diesel-Requirements and test methods**

#### **General Directorate of Standardization**

Address: Street “Mine Peza”, 143/3, Mailbox; 98, Tirana

TEL: +355 42 22 62 55; Fax:+355 4224 7177

E-mail: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al)

---

### **GDS**

Reproduction is prohibited. The exclusive right to publish and sell the Albanian Standards rests with GDS.

### **AL ST EN 590:2013**

### **Introduction**

General Directorate of Standardization, GDS, is the National Body of Standardization in the Republic of Albania.

GDS drafts, approves and publishes albanian national standards, and also adopts and publishes european and international standards, giving them the status of Albanian Standards (AS). The same competences has and for standardization documents. Their formal approval is made by General Director of GDS.

Albanian Standards are drafted and adopted by Technical Committees (TC). Members of technical committees are specialists of state and private entities from different fields of economy that engage voluntarily in this process.

Standard EN 590:2013 is drafted by CT 19 and is approved by GDS as standard ON 2014-01-10. Standard ST AL EN 590:2013 is published for the first time.

---

Standards reviewed when it is necessary, so is essential that the user will take the latest publication and its amendments, if there is such.

STANDARDI EVROPIAN

EN 590

Shtator 2013

ICS 75.160.20

Zëvendëson EN 590:2009+A1:2010

Versioni Anglisht

Karburantet e automobilave-Naftë-Kërkesat dhe metodat e provës

Karburantet për automobilat

Ky standard evropian u miratua nga CEN (Komiteti Evropian i Standardizimit) me date 26 Korrik 2013.

Anëtarët e KES(CEN) janë të detyruar të përputhen me rregulloret e brendshme të KES/CENLEC, të cilat përcaktojnë kushtet që këtij Standardi Evropian t'i japin pa asnjë ndryshim statusin e një standardi kombëtar. Listat e azhornuara dhe referencat bibliografike në lidhje me këto standarde kombëtare mund të merren për aplikim në Qendrën e Menaxhimit të CEN-CENELEC apo të ndonjë anëtari të CEN.

Ky Standard Evropian ekziston në tre versione zyrtare (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht). Versioni në çdo gjuhë tjetër, i përkthyer nën përgjegjësinë e një prej anëtarëve të CEN në gjuhën e tij dhe i raportuar në Qendrën e Menaxhimit të CEN-CENELEC ka të njëjtin status me versionin zyrtar.

Anëtarët e CEN janë organet e standardeve kombëtare të Austrisë, Belgjikës, Bullgarisë, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Islandë, Irlandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Malta, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

CEN

KOMITETI EUROPIAN I STANDARDIZIMIT

Qendra e Menaxhimit: Avenue MARNIX 17, B-1000 Bruksel

---

2013 CEN Të gjitha të drejtat e shfrytëzimit në çdo formë dhe me çdo mjet rezervohen në mbarë botën për Anëtarët kombëtare të CEN.

Ref Nr. EN 590:2013

EN 590:2013

Përmbajtja	Faqe
Parathënie .....	3
1.Qëllimi.....	4
2.Referencat normative.....	4
3.Kampionimi.....	6
4. Pompa e Shënjimit.....	6
5. Kërkesat dhe metodat e provës.....	6
5.1 Ngjyrosësit dhe shënuesit.....	6
5.2 Aditivë (lëndët shtesë).....	6
5.2.1Përgjithësime.....	6
5.2.2 Methylcyclopentadienyl mangan tricarbonyl (MMT).....	6
5.3 Acidi (i ngopur) metil ester (FAME) .....	6
5.4 Përbërës të tjerë bio.....	7
5.5 Kërkesat përgjithësisht të aplikueshme dhe metodat përkatëse të testimit ..	7
5.6 Kërkesat në varësi të klimës dhe metodat përkatëse të testimit.....	9
5.7 Saktësia dhe Kontestimet.....	10
Annex A (normativa) Detajet e programit të testimit ndër-laboratorik.....	11
Bibliografia.....	12

EN 590:2013 (E)

Parathënie

Ky dokument (EN 590:2013) është përgatitur nga Komiteti Teknik CEN / TC 19 \*Lëndë djegëse të gazta dhe të lëngëta; lubrifikantë dhe produkteve të përafërta të naftës, sintetike dhe me origjinë biologjike \*sekretariati i te cilave është mbajtur nga NEN.

Këtij Standardi Evropian do t'i jepet statusi i një standardi kombëtar, qoftë nga publikimi i një teksti të njëjtë ose miratimin e tij, jo më vonë sesa Mars 2014 dhe standardet kontradiktore kombëtare do të tërhiqen para Marsit të 2014-ës.

Është tërhequr vëmendja se disa prej elementeve të këtij dokumenti mund të jenë subjekt i të drejtave të patentës. CEN (dhe/ose CENELEC) nuk do të jetë përgjegjëse për identifikimin e ndonjë apo të gjithave të drejtave të patentës të këtij lloji.

Ky dokument zëvendëson EN 590:2009+A1:2010.

Ky dokument është përgatitur sipas autorizimit që Komisioni Evropian dhe Shoqata e Tregtisë së Lirë Evropiane (5) i kanë dhënë CEN.

Kërkesat e Direktivës Evropiane të Lëndëve Djegëse (Karburantet) 98/70/EC (1); përfshirë dhe amendamentet: 2003/17/EC (2); 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EC (4). Datat janë të përfshira me të gjitha referencat normative të metodës së provës, në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e Komisionit Evropian; me sigurinë që përcillet nga CEN/TC (Komiteti Evropian i

Standardizimit/Komiteti Teknik) 19 se çdo version i azhurnuar dhe i referuar do të japë gjithmonë saktësi të përafërt dhe me të njëjtin precizion, madje edhe më të mirë (shih (4).

Ndryshime teknike të dukshme midis Standardit Evropian dhe botimit të mëparshëm janë:

-Përfshirja e rishikimit të specifikimit FAME tek EN14214

-Kërkesat specifike në lidhje me kufizimin e përdorimit të Methylcyclopentadienyl mangan tricarbonyl (MMT), janë përfshirë ashtu siç kërkohet nga Komisioni Evropian.

- Shtimi i Testerit për ndezjen e karburantit (EN 16144), si një metodë alternative e testimit në provën e motorit CFR.

-Shtimi i distilimit të simuluar me gaz kromatografik (GC), EN ISO 3924, si një metodë alternative e testimit e distilimit sipas EN ISO 3405.

-Futja në përdorim e teknikave të përmirësuara dhe përcaktuese EDXRF për përmbajtje të ulët squfuri, EN ISO 13032, duke zëvendësuar EN ISO 20847.

Aneksi A është normativ dhe përmban të dhëna të sakta të metodave të provës, të cilat janë rezultat i testimeve ndërlaboratorike, të kryera nga grupet e punës të CEN/TC (Komiteti Evropian i Standardizimit/Komiteti Teknik) 19. Shumë prej metodave të provës të përfshira në këtë standard ishin subjekt i testimit ndër-laboratorik për të përcaktuar zbatueshmërinë e metodës dhe saktësinë e saj në lidhje me përzierjen e naftës së automobilave me përmbajtje 10 % (V/V) ose më të lartë nga burime të ndryshme të FAME (Acidit të ngopur metil ester).

Në përputhje me rregulloren e brendshme të CEN/CENELEC (Komiteti Evropian i Standardizimit), organizatat e standardeve kombëtare të shteteve të mëposhtëm janë gati për implementimin e këtij Standardi Evropian, konkretisht: Austria, Belgjika, Kroacia, Qipro, Republika e Çekisë, Danimarka, Estoni, Finlandë, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, FRANCA, Gjermani, Greqi, HUNGARI, Islandë, Irlandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, MALTA, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Turqi dhe Mbretëria e Bashkuar.

EN 590:2013 (E)

### 1. Qëllimi

Ky Standard Evropian specifikon kërkesat dhe metodat e provës të tregtimin dhe shpërndarjen e naftës automotive. Ai është i aplikueshëm në lëndën djegëse të naftës automotive për përdorim në automjetet me motor naftë, të dizenuar për të ecur me lëndë djegëse të naftës automotive me përmbajtje 7,0 % (V/V) FAME (Acidit të ngopur metil ester).

Shënim: Në funksion të këtij standardi evropian, termat ose shenjat % (m/m) dhe % (V/V), përdoren për të përfaqësuar respektivisht: pjesën takuese të lëndës në masë dhe volum.

### 2. Referencat normative

Dokumentet e mëposhtme, në tërësi ose pjesërisht, u janë referuar normativave dhe janë të domosdoshme për aplikimin e tij. Për referencat e datuara aplikohet vetëm edicioni i përmendur. Për referencat e padatuara aplikohet the edicioni i fundit i dokumentit të referuar (duke përfshirë çdo amendament).

EN 116:1997 (1), Naftë dhe lëndë djegëse për ngrohje shtëpiake - përcaktimi i filtrit të ftohtë të pikës së mbylljes.

EN 12662:2012, Produkte të lëngshme, derivate të naftës- Përcaktimi i kontaminimit total në distilatet e mesme- karburantet naftë dhe FAME, acid i ngopur metil ester.

EN 12916:2006, derivate të naftës- Përcaktimi i tipeve hidrokarbon aromatike në distilatet e mesme-metoda e performanës së lartë të kromatografisë likuide me zbulimin e indeksit të refrakcionit.

EN 14078:2009, Produktet e lëngshme të naftës-përcaktimi i përmbajtjes së acidit të ngopur ester metil (FAME) në distilatet e mesme-metoda e spektrometrit infrared.

EN 14214:2012, Produktet e lëngshme të naftës- acidi i ngopur ester metil (FAME) për përdorim në motorat e naftës dhe aplikacionet e ngrohjes-kërkesat dhe metodat e provës.

EN 15195:2007, Produktet e lëngshme të naftës-Përcaktimi i vonesës në ndezje dhe numri i rrjedhjeve të cetanit(DCN) në distilate të mesme të lëndëve djegëse nga djegia në një dhomë me të njëjtin vëllim.

EN 15751: 2009, Karburantet Automotive- acidi i ngopur ester metil (FAME) në karburantet dhe përzierjet me naftë-Përcaktimi i Stabilitetit të oksidimit me metodën e oksidimit të përshpejtuar.

EN 16144:2012, Produktet e lëngshme të naftës— Përcaktimi i vonesës në ndezje dhe numri i rrjedhjeve të cetanit (DCN) në distilate të mesme të lëndëve djegëse- periudhë me normë fikse injektimi, metoda e djegies në dhomë me vëllim të njëjtë.

EN 16329: 2013, Naftë dhe lëndë djegëse për ngrohje shtëpiake- përcaktimi i filtrit të ftohtë të pikës së mbylljes- Metoda e “dushit” të ftohtë linear.

EN 16576:2013, Lëndët Djegëse automotive-përcaktimi i përmbajtjes së manganit dhe hekurit në distilatet e mesme të lëndëve djegëse-metoda e plazmës së shoqëruar në mënyrë induktive me Spektrometrine e emisionit optik (ICO OES).

EN 23015:1994, derivate të naftës-Përcaktimi i pikës së ftohtë (ISO 3015:1992).

EN ISO 2160:1998, derivate të naftës- korrozionit të bakrit-provë shirit bakri (ISO 2160:1998)

EN ISO 2719:2002, Përcaktimi pikës së nxehtë-Pensky-Martens metoda e kupës së mbyllur (ISO 2719.2002)

- 
- 1) nën rishikim
  - 2) në përgatitje
  - 3) ky dokument aktualisht ndikohet nga EN 14214:2012 /Fpr A1:2013.

EN ISO 3104:1996, Derivate të naftës-lëngjet transparente dhe të patejdukshëm-Përcaktimi i viskozitet kinematik dhe përlllogaritja e viskozitetit dinamik. (ISO 3104:1994)

EN ISO 3170:2004, Produktet e lëngshme të naftës -Kampionimi manual (iso 3170:2004)

EN ISO 3171:1999, Produktet e lëngshme të naftës -Kampionimi (marrja e mostrave) të Tubacionit Automatik. (ISO 3171:1988).

EN ISO 3405: 2011, Derivate të naftës-Përcaktimi i karakteristikave të distilimit në presion atmosferik (ISO 3405:2011)

EN ISO 3675:1998, derivate të naftës bruto dhe produkte të lëngshme të naftës-Përcaktim laboratorik i densitetit-metoda e hidrometrit (ISO 3675: 1998).

EN ISO 3924:2010, Derivate të naftës-përcaktimi i shpërndarjes së gradës së vlimit-metoda e gazit të kromatografisë (ISO 3924:2010).

EN ISO 4259:2006 , Derivate të naftës-përcaktimi dhe aplikimi i të dhënave precize në lidhje me metodat e provës(ISO 4259:2006).

EN ISO 4264:2007, Derivate të naftës-llogaritja e indeksit të cetanit në distilatet e mesme të lëndëve djegëse me ekuacionin e katër variablave (ndryshore0 (ISO 4264: 2007)

EN ISO5165:1998, Derivate të naftës-përcaktimi i cilësisë së ndezjes së lëndëve djegëse të naftës-metoda e motor Cetanit (ISO 5165:1998)

EN ISO 6245:2002, Derivate të naftës-Përcaktimi i hirit (ISO 6245:2001)

EN ISO 10370:1995, Derivate të naftës-përcaktimi i mbetjeve të karbonit- metoda mikro(ISO 10370:1993)

EN ISO 12156-1:2006, Karburanti naftë-vlerësimi i përdorimit të lubrifikantëve duke përdorur pajisje të dyanshme me frekuencë të lartë (HFRR) -Pjesa 1, metoda e provës (ISO 12156-1:2006).

EN ISO 12185:1996, derivate të naftës bruto dhe derivate të naftës- Përcaktimi i densitetit-Metoda e gypave U lëkundës (ISO 12185;1996)

EN ISO 12205:1996, Derivate të naftës-Përcaktimi I stabilitetit të oksidimit në distalet të mesme të lëndëve djegëse (ISO 12205:1995)

EN ISO 12937:2000, Derivate të naftës-Përcaktimi I ujit-Metoda e titrimit Coulometric Karl Fischer(ISO 12937:2000)

EN ISO 13032:2012, Derivate të naftës-Përcaktimi i përqendrimit të ulët të squfurit në karburantet automotive-metoda spektrometrike e ndriçimit fluoreshent nga energjia- e shpërndarjes së rezeve X ( ISO 13032:2012)

EN ISO 13759:1996, Derivate të naftës-Përcaktimi i nitratis alkil në lëndët djegëse të naftës-metoda spektrometrike (ISO 13759:1996).

EN ISO 20846: 2011, Derivate të naftës-Përcaktimi i përmbajtjes së squfurit në karburantet automotive-metoda fluoreshente ultraviolettë(ISO 20846:2011).

EN ISO 20884:2011, Derivate të naftës-përcaktimi i përmbajtjes së squfurit në karburantet automotive—spektrometria e ndriçimit fluoreshent në shpërndarjen sipas gjatësisë së valës të rezeve X (iso 20884:2011)

---

Ky dokument aktualisht ndikohet nga EN ISO 4264:2007/A1:2013.

EN 590:2013 (E)

### 3. Kampionimi

Mostrat (kampionet) do të merren siç është përshkruar në EN ISO 3170 ose EN ISO 3171 dhe /ose në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare ose rregullimet për marrjen e mostrave

në karburantet automotive. Kërkesat kombëtare do të përcaktohen në detaj ose do t'i referohen një Aneksi Kombëtar të këtij Standardi Evropian.

Për të parë ndjeshmërinë e disa prej metodave të provës të referuara në këtë Standard Evropian, një kujdes i veçantë do t'i kushtohet përmbushjes me çdo udhëzues në mbajtësit e mostrave të përfshira në standardin e metodës së provës.

#### 4. Pompat e shënjimit

Informacioni që duhet të shënohet në pompat shpërndarëse të përdorura për dërgimin e karburanteve automotive dhe përmasat e shënjimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare ose instruksioneve për shënimin e pompave për karburantet automotive.

Këto kërkesa do të përcaktohen në detaj ose do t'i referohen një Aneksi Kombëtar të këtij Standardi Evropian.

Etiketimi do të jetë qartësisht i dukshëm, lehtësisht i lexueshëm dhe i ekspozuar në çdo pikë ku nafta me shtesat metalike u është ofruar konsumatorëve. Etiketa duhet të përmbajë shënimin "Përmban lëndë shtesë metalike", në gjuhën/t kombëtare dhe duhet të shtjellohet në Aneksin Kombëtar të këtij dokumenti.

#### 5. Kërkesat dhe metodat e provës

##### 5.1 Ngjyrosësit dhe shënuesit

Lejohet përdorimi i ngjyruësve ose shënuesve.

##### 5.2 Aditivët (lëndët Shtesë)

###### 5.2.1 Përgjithësime

Për të përmirësuar cilësinë e performancës lejohet përdorimi i aditivëve, lëndëve shtesë. Edhe pa ditur efektet anësore të dëmshme, lëndët shtesë të përshtatshme për karburantet rekomandohen në sasinë e duhur, për të ndihmuar në shmangien e përkeqësimit të funksionimit të automjetit dhe kontrollit të qëndrueshmërisë së emisionit. Gjithashtu mund të përdoren mjete të tjera teknike që kanë të njëjtat efekte.

Shënim : metodat e provës për tendencën e depozitimit të përshtatshme për qëllime të kontrollit rutinë nuk janë identifikuar dhe zhvilluar akoma.

###### 5.2.2 Methylcyclopentadienyl mangan tricarbonyl (MMT)

Kur përdoret Methylcyclopentadienyl mangan tricarbonyl (MMT) kërkohet një etiketim i specifikuar (shih Klauzolën 4).

MMT është një lëndë shtesë metalike që mund të përdoret në naftë. Prania e MMT-së tek nafta duhet të limitohet në 6 mg Mangan për litër, që nga 1 Janari 2011. Ndërsa nga 1 Janar 2014 sasia e limituar për manganin duhet të shkojë deri në 2 mg mangan për litër.

Shënim : këto kërkesa janë subjekt i parashikimeve të vlerësimit nga Komisioni Evropian.

###### 5.3 Acid i ngopur metil ester (FAME)

Lënda djegëse e naftës mund të përmbajë më shumë se 7, 0% (V/V) FAME që krahasuar me EN 14214:2012, rast në të cilin kërkesat e varura klimaterike të përcaktuara në 5.4.2 të EN 14214:2012 nuk aplikohen.

Shënim 1: metoda e përshtatshme për ndarjen dhe identifikimin e FAME përcaktohet në EN 14331 (6).

Kërkesat që varen nga klima për FAME si një komponent i përzierjes për t'u përdorur në karburantet e naftës, duke iu referuar këtij dokumenti janë të përcaktuara në 5.4.3 të EN 14214:2012. Masa e specifikuar duhet të përcaktohet mbi një bazë kombëtare, në përputhje me kushtet klimaterike lokale dhe volumit të FAME në lëndën e naftës.



Përzierja e përfunduar e naftës duhet gjithashtu që të përmbushë kërkesat në varësi të klimës të përcaktuara në 5.6 të këtij dokumenti.

Aditivët (lëndët shtesë) rrjedhës të ftohtë, kur përdoren në FAME, duhet të përkojnë me bazën e karburantit dhe cilësia e FAME duhet të sigurojë një performancë korrekte e konsekuente me kërkesat e vendosura prej këtij Standardi EVROPIAN. Zgjedhja mund të rezultojë në papërputhshmëri të aditivëve me rrjedhje të ftohtë të përdorur në FAME dhe karburantit. Zgjedhja e teknologjisë së aditivëve me rrjedhje të ftohtë do të jetë një çështje kontraktuale midis përzierjes së karburantit dhe furnizuesit FAME duke marrë për bazë kërkesat në varësi të klimës të karburantit final.

Shënim 2: kërkesat e rrjedhjes së ftohtë për FAME si një përbërës I përzierjes së karburantit është e përcaktuar në tabelën 3a dhe 3b dhe në Aneksin Kombëtar të EN 14214:2012, me qëllim kontrollin maksimal mbi përbërjen e ngopur të monoglicerideve në përzierjen finale EN 590 për sigurimin e një operacioni pa problem. Puna e vazhdueshme për identifikimin e një metode të përshtatshme të provës për monogliceridet e ngopura, ose një test performance për kontrollin e këtij aspekti në performancën e një temperature të ulët.

Me qëllim përmirësimit e qëndrueshmërisë së oksidimit të FAME, është rreptësisht e rekomanduar që të shtohet qëndrueshmëria e oksidimitme rritjen e aditivëve tek FAME në fazën e prodhimit ose para magazinimit, për të siguruar një qëndrueshmëri oksidimi të përafërt me 1000 mg/kg të 2,6-di-tert-butyl-4-hidroksitoluen (BHT, zyrtarisht e caktuar nga IUPAC si 2,6-bis(1,1-dimetiletil-4-metilfenol).

Veprimi I përafërt mund të lexohet si arritja e një performance të sigurt të qëndrueshmërisë së oksidimit, e njëjtë me normën prej 1000 mg/kg të BHT.

KUJDES: ka një rrezik potencial në formimin e nxituar të një qëndrueshmërie të oksidimit me rritjen e aditivëve në temperature të ulëta në karburant arktik të ulët aromatic. Duhet bërë kujdes në zgjedhjen e qëndrueshmërisë së oksidimit me rritjen e aditivëve në normën arktike të FAME.

#### 5.4 Përbërës të tjerë bio

Kufizimet në shtimin e FAME vendosen për arsye teknike. Kufizimet për FAME nuk aplikohen në hidrokarbure të tjera (të rinovueshme) si Hidrokarbur i Naftës VEGJETAL (HVO), gaz i lëngshëm (GTL), ose Biomasa me lëngje (BTL) hidrokarbure të derivuara, kjo derisa këta përbërës parafine të karburanteve arrijnë në masat e lejuara për sigurimin e një përzierjeje finale që përmbush kërkesat e EN 590. Gjithashtu përdorimi i rezervave të rinovueshme në rafineri lejohet deri në kushtet e sigurimit të një karburanti final që përkon me kërkesat e EN 590.

Shënim: drafti i specifikimit të karburantit për lëndët djegëse parafine është zhvilluar në (7).

#### 5.5 Kërkesat përgjithësisht të zbatueshme që lidhen me metodat e provës

5.5.1 Kur testimet bëhen me metodat e renditura në Tabelën 1, karburantet automotivë do të jenë në përputhje me kufijtë e specifikuar në Tabelën 1. Metodatat e provës të listuara në Tabelën 1 janë vlerësuar për aplikimin në karburantet automotivë që përmbajnë FAME. Të dhënat e sakta nga programet e testeve ndër-laboratorike janë dhënë në normativën e Aneksit A, të cilat rezultojnë të jenë të ndryshme nga të dhënat e rezultuara prej metodave të provës për produktet e naftës së pastër.

5.5.2 Vlera e limituar e karbonit të mbetur që jepet në Tabelën 1, bazohet në produktin primar në qoftë se përmirësuesi I ndezjes është përdorur. Në qoftë se një vlerë kalon limitin dhe përfshihet në karburantin final në treg, EN ISO 13759 do të përdoret si një indikator i prezencës së një përmbajtjeje nitrati të përberë. Në qoftë se një përmirësues i ndezjes është i pranishëm, vlera e limituar e karbonit të mbetur të produktit nën testim nuk mund të aplikohet. Përdorimi i aditivëve

nuk përjashton prodhimin për arritjen e kërkesës së maksimumit 0.30 % (m/m) e karbonit të mbetur, me qëllim shtimin e aditivëve.

5.5.3 Karburanti i naftës nuk duhet të përmbajë adulterante (përbërës simulues të ndërveprimit të lendeve midis tyre) ose kontaminant që mund ta shndërrojë karburantin të papranueshëm për t'u përdorur në motorin e naftës së automjeteve.

Shënim: për informacion të mëtejshëm për ndalimin e kontaminimit me ujë ose sedimentin (krijimi I llumit) që mund të ndodhë në ofertën zinxhir, ose për kontaminimin e kryqëzuar, këshillohet të kontrolloni respektivisht tek CEN/TR 15367-1(8) ose CEN /TR 15367-3(9).

EN 590:2013

Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celsius	Kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10%mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (wsd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1

Dokumentat Standarde të Tenderit

Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm <sup>2</sup> /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius	% (V/V)		Më pak se 65	EN ISO 3405 EN ISO 3924
% (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius	% (V/V)	85	360	
95 % (V/V) rafinimi në	Gradë celsius			
Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).				
<p>a. Shih gjithashtu 5.7.1.</p> <p>b. Shih gjithashtu 5.7.4.</p> <p>c. Shih gjithashtu 5.7.2.</p> <p>d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.</p> <p>e. Shih gjithashtu 5.7.3.</p> <p>f. Shih gjithashtu 5.2.2.</p> <p>g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.</p> <p>h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.</p> <p>i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).</p> <p>j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.</p> <p>k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.</p> <p>l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.</p> <p>m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.</p>				

5.6 Kërkesat e varura ndaj klimës dhe metodat e provës që lidhen me të

5-6-1 Për kërkesat e varura ndaj klimës, opsionet jepen për të lejuar vendosjen e gradave sezonale kombëtare. Opsionet janë për gjashtë klasat e parametrave klimatike CFPP (filtri I ftohte në pikën e mbylljes) dhe për klasat e ndryshme klimaterike arktike dhe dimër të ashpër. Kërkesat e varura ndaj klimës jepen në Tabelën 2 (zonat klimaterike) dhe Tabela 3 (klima arktike dhe dimërore). Gjatë testimit me metodat e dhëna në Tabelën 2 dhe Tabelën 3, karburantet automotivë duhet të jenë në përputhje me limitet e specifikuar në tabelë.

Tabela 2-kërkesat e varura ndaj klimës dhe metodat e e provës-Temperature climates

Substanca	Njësia e matjes	Limitet (normat)						Metoda e provës (shih klauz. 2)
		Shkalla A	Shkalla B	Shkalla C	Shkalla D	Shkalla E	Shkalla F	
CFPP	Gradë Celsius	+ 5	0	-5	-10	-15	-20	EN 116 EN

Dokumentat Standarde të Tenderit

								16329
a. Shih gjithashtu 5.7.1 b. Shih Gjithashtu 5.7.6								

Tabela 3-Kërkesat e varura ndaj klimës dhe metodat e provës-klima arktike dhe me dimër të ashpër

Substanca	Njësia	Limitet normat					Metoda e provës(shih 2)
		Class 0	1	2	3	4	
CFPP	Gradë Celsius, maks	-20	-26	-32	-38	-44	EN 116 EN 16329
Pika e CLOUD	Gradë Celsius, maks	-10	-16	-22	-28	-34	EN 23015
Densiteti në 15 gradë	Kg/m <sup>3</sup> , min Kg/m <sup>3</sup> , maks	800,0 845,0	800,0 845,0	800,0 840,0	800,0 840,0	800,0 840,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Viskoziteti në 40 gradë	Mm <sup>2</sup> /s, min Mm <sup>2</sup> /s, maks	1,500 4,000	1,500 4,000	1,500 4,000	1400 4,000	1,200 4,000	EN ISO 3104
Numri i Cetanit EU	Minimum	51,0	51,0	51,0	51,0	51,0	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Numri i Cetanit	Minimum	49,0	49,0	48,0	47,0	47,0	EN ISO 5165 EN 15195 EM 16144
Indeksi i Cetanit	Minimum	46,0	46,0	46,0	43,0	43,0	EN ISO 4264
Distilimi Recovered në 180 gradë	% (V/V) max	10,0	10,0	10,0	10,0	10,0	EN ISO 3405
Distilimi Recovered në 340 gradë	% (V/V), min	95,0	95,0	95,0	95,0	95,0	EN ISO 3924
a. Shih gjithashtu 5.7.1 b. Shih gjithashtu 5.7.6 c. Shih gjithashtu 5.7.2 d. Shih gjithashtu 5.7.4							

e. Në vendet ku aplikohet direktiva evropiane e karburanteve 98/70 EC (1) përfshirë amendamentet 2003/17/EV (2), 2009/30/EC (3) DHE 2011/63/EU (4).

f. në vendet ku nuk aplikohet direktiva evropiane e karburanteve 98/70 EC (1) përfshirë amendamentet 2003/17/EV (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).

g. Caktimi I tarifës së doganave të përbashkëta BE për GAS OIL, nuk mund të aplikohet gradët e caktuara për t'u përdorur në klimat arktike dhe me dimër te ashpër.

h. për llogaritjen e indeksit të cetanit 10 % (V/V), 50% (V/V) dhe 90 % (V/V) gjithashtu nevojiten pikat e recovery.

i. shih gjithashtu 5.7.5

EN 590:2013 (E)

5.6.2 Në një Aneks Kombëtar të këtij Standardi Evropian çdo vend do të detajojë kërkesat për gradat e verës dhe të dimrit dhe mund të përfshijë një gradë rajonale e cila do të justifikohet nga të dhënat kombëtare meteorologjike.

5.7. Saktësia dhe kontestime

5.7.1 Të gjitha metodat e e provës të referuara në këtë standard evropian përfshijnë një deklaram të saktë. Në rastet e kontestimeve, procedurat për zgjidhjen e tyre dhe interpretimi i këtyre rezultateve bazohet në saktësinë e metodës së provës, janë të përshkruara në EN ISO 4259 .

5.7.2 Në rastet e kontestimeve që lidhen me densitetin do të përdoret EN ISO 3675.

5.7.3 Në rastet e kontestimeve që lidhen me përmbajtjen e squfurit në këto përbërje do të përdoren: EN ISO 20846 dhe EN ISO 20884.

5.7.4 Në rastet e kontestimeve që lidhen me numrin e cetanit do të përdoret EN ISO 5165. Për përcaktimin e numrit të cetanit mund të përdoren metodat alternative me ato tabelës 1 dhe 3, duke u siguruar se këto vijnë nga një seri metodash të njohura dhe kanë një deklaram të saktë të dhënash, dhe në përputhje me EN ISO 4259, në të cilën demonstronhet një saktësi e barabartë me atë të metodave që merren si referencë.

Rezultati i provës në rastin e përdorimit të një metode alternative, do të ketë gjithashtu një lidhje domethënëse me të dhënat që vijnë nga përdorimi I metodës së marrë si referencë.

5.7.5 në rastet e kontestimeve që lidhen me distilimin do të përdoret EN ISO 3405.

5.7.6 Në rastet e kontestimeve që lidhen me CFPP do të përdoret EN 116.

## **Aneksi A** **(normative)**

Tabela A.1 paraqet saktësinë e të dhënave të marra nga programet e testeve nder-laboratorike të bëra nga CEN/TC 19 (10) dhe EI (11) që ndryshojnë nga metodat e provës të tabelës 1 dhe që në momentin e publikimit të këtij standardi evropian nuk ishin rishikuar ende.

Shënim, : metodat e mëposhtme janë bërë me qëllim që të kenë një saktësi të të dhënave për përzjerjet me 5 % (V/V) FAME, me këto vlera të publikuara:

-përmbajtja e hirit EN ISO 6245

-Qëndrueshmëria Oksidimit EN ISO 12205

-CFPP EN 116

Tabela A1-Të dhënat sakta të azhornuara

Substance	Metoda e provës	Njësia	Të dhënat e CEN/TC 19 për përzierjen me 5 % (V/V) FAME
Viskoziteti në 40 gradë	EN ISO 3104		r=0,001 1 X R=0,018 X
Pika e ndezjes	EN ISO 2719		r=2,0 R=3,5
Karboni i mbetur	EN ISO 10370	% (m/m)	r=0,143 0 X <sup>(0,5)</sup> R=0,212 5 X <sup>(0,5)</sup>
<p>Ku: _                      r është përsëritja (EN ISO 4259)                      R është riprodhimi (EN ISO 4259)                      X është mjeti i krahasimit midis dy rezultateve</p>			

### Bibliografia

1. Direktiva 98/70/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshilli I 13 tetorit 1998 që lidhet me cilësinë e karburanteve dhe naftës, dhe Direktivën e ndryshuar të Këshillit 93/12/EEC
2. Direktiva 2003/17/EC e parlamentit Evropiane dhe direktiva e ndryshuar 98/70/EC e Këshillit të 3 Marsit 2003, që lidhet me cilësinë e karburanteve dhe naftës, dhe në Direktivën e ndryshuar të Këshillit 93/12/EEC .
3. Direktiva 2009/30/EC e Parlamentit Evropian dhe direktivës së ndryshuar 98/70 /EC te Këshillit më 23 prill 2009 që lidhet me specifikimin e karburantit, naftës dhe gazit-oil dhe paraqitja e një mekanizmi për kontrollin dhe reduktimin e emisionit të gazrave të dëmshme, dhe direktiva e ndryshuar e Këshillit e 1993/32/EC që lidhet me specifikimin e karburantit të përdorur nga VESSELS E UJËRAVE nëntokësore dhe Direktiva 93/12/EEC.
4. Direktiva e ndryshuar 2011/63/EU e 1 qershorit 2011, me qëllim adaptimin e saj në progresin teknik, Direktiva 98/70/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që lidhet me cilësinë e karburantit dhe naftës.
5. Mandate M/394-Mandati I CEN në rishikimin e EN 590 për rritjen e përbërjes së FAME dhe FAEE në 10% (V/V), 13 Nëntor 2006.
6. EN 14331:2004, produkte të lëngshme të naftës-ndarja dhe karakterizimi I FAME nga distilatet e mesme-Metoda e Kromatografisë së lëngshme (LC/gaz i kromatografisë (GC).
7. CEN/TS 15940, Karburantet automotive-karburanti parafinat nga sintetiket ose hidrotrajtimeve-kërkesat dhe metodat e provës
8. CEN/TR 15367-1, derivate te naftës-instruksione për mirëmbajtje të mirë në kushtet shtëpiake-pjesa 1, Karburantet Automotive
9. CEN/TR 15367-3,Derivate të naftës –instruksione për mirëmbajtje të mirë në kushtet shtëpiake-Pjesa 3 Kontaminimi kryqëzuar

10. CEN/TR 15160 Nafta dhe produktet e saj –Zbatueshmëria e metodave të provës për FAME –Informacioni dhe rezultatet testet ROUND ROBIN
11. EI Raporti I Kërkimeve në IP 398 dhe EN ISO 10370, në publikim e sipër, e disponueshme nga Instituti I Energjisë, 61 Në Cavendish Street, Londër W1G 7AR, Angli.

## **STANDARDI EUROPIAN**

**EN 590: 2013/AC**

**MARS 2014**

---

ICS 75.160.20

Versioni anglez

Version francez

Version gjerman

Karburantet automotive-nafta-kërkesat dhe metodat e provës

Ky CORRIGENDUM hyn në fuqi më 5 Mars 2014 për bashkëpunimin në tre versionet e gjuhëve zyrtare të SE.

CEN -CENELEC

Qendra e Menaxhimit: Avenue MARNIX 17, B-1000 Bruksel

---

2013 CEN Të gjitha të drejtat e shfrytëzimit në çdo formë dhe me çdo mjet rezervohen në mbarë botën për Anëtarët kombëtare të CEN.

### **EN 590 :2013 /AC: 2014 (E)**

#### 1. Modifikimet e 5.5.3

Në tabelën 1, në shënimin “j”, zëvendëso “kur karburanti përmban më shumë sesa 2% (V/V) FAME, kërkesa për qëndrueshmërinë e oksidimit përcaktohet në EN 15751” me “Për përbërjet me 2% (V/V) FAME ka një kërkesë shtesë”.

Në tabelën 1, në rreshtin 14 për qëndrueshmërinë e oksidimit, në kolonën e 1, fshi pikën “j” dhe në kolonën e 3 shto “j” (e njëjta pikë) pas “20”.

### **EN 228:2012 (E)**

STANDARDI EVROPIAN

Tetor 2012

---

ICS 75.160.20

Zëvendëson EN 228:2008

Versioni Anglisht

### **Karburantet automobilistike – Benzinë pa plumb – Kërkesa dhe metoda testimi**

Standardi Evropian është aprovuar nga CEN, më 1 Shtator 2012

Anëtarët e CEN janë të detyruar të jenë në përputhje me Rregulloret e Brendshme të CEN/CENELEC të cilat përcaktojnë kushtet për dhënien këtij Standardi Evropian të statusit të një standardi kombëtar pa asnjë ndryshim. Listat e përditësuara dhe referencat bibliografike lidhur me të tilla standarde kombëtare mund të përftohen në aplikim ndaj Qendrës së Menaxhimit CEN/CENELEC ose ndaj ndonjërit nga anëtarët e CEN.

Standardi Evropian ekziston në tre versione zyrtare (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht). Një version në çdo gjuhë tjetër i bërë me përkthim nën përgjegjësinë e një anëtari të CEN në gjuhën e vet dhe i regjistruar në Qendrën e Menaxhimit të CEN/CENELEC ka të njëjtin status si versionet zyrtare.

Anëtarët e CEN janë bordet kombëtare të standardeve të Austrisë, Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Spanjës, Suedisë, Zvicrës, Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

LOGO

ADRESA

**EN 228:2012 (E)**

<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>Parathënie.....</b>	<b>3</b>
<b>1. Fusha e shtrirjes.....</b>	<b>5</b>
<b>2. Referencat normative.....</b>	<b>5</b>
<b>3. Marrja e mostrave.....</b>	<b>6</b>
<b>4. Markerimi i pompave.....</b>	<b>7</b>
<b>5. Kërkesat dhe metodat e provës.....</b>	<b>7</b>
<b>5.1.Etanoli.....</b>	<b>7</b>
<b>5.2.Ngjyrat dhe shenjat.....</b>	<b>8</b>
<b>5.3.Shtesat.....</b>	<b>8</b>
<b>5.4.Kërkesa të përgjithshme aplikimi dhe metodat e provës.....</b>	<b>8</b>
<b>5.5.Kërkesat që varen nga klima dhe metodat e provës.....</b>	<b>11</b>
<b>5.6.Raportimi i oktanit.....</b>	<b>14</b>
<b>5.7.Saktësime dhe diskutime .....</b>	<b>14</b>
<b>Aneksi A (normativ) Toleranca për presionin e avullit.....</b>	<b>15</b>
<b>Bibliografia.....</b>	<b>16</b>



## EN 228:2012 (E)

### Parathënie

Ky dokument (EN 228:2012) është përgatitur nga Komiteti Teknik CEN/TC 19 “Karburantet e gazta dhe të lëngëta, lubrifikantet dhe produktet e lidhura me benzinën të origjinës sintetike dhe biologjike”, sekretariati i të cilit mbahet nga NEN.

Këtij Standardi Evropian do t’i jepet statusi i një standardi kombëtar ose me publikimin e një teksti identik, ose me kundërfirmë, jo më vonë se muaji Prill 2013 dhe standardet kombëtare që bien ndesh me të do të tërhiqen jo më vonë se muaji Prill 2013.

Tërhiqet vëmendja ndaj mundësisë që disa nga pjesët e këtij dokumenti mund të jenë subjekt i të drejtave të patentës. CEN (dhe/ose CENELEC) nuk do të jenë përgjegjës për të identifikuar ndonjë apo të gjitha të drejta patentash të tilla.

Ky dokument zëvendëson EN 228:2008

Originali i këtij dokumenti u përgatit nën mandatin e dhënë ndaj CEN nga Komisioni Evropian dhe Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë. Veç standardeve të tjera, ai synon të jetë komplementar ndaj masave rregulluese që përmbahen në Direktiva të ndryshme të BE-së.

Më poshtë është një listë e ndryshimeve më të rëndësishme teknike midis këtij Standardi Evropian dhe edicionit të mëparshëm:

- Janë marrë parasysh kërkesa të reja në vijim të amendamenteve 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4) të Direktivës Evropiane të karburanteve 98/70/EC (1). Pasqyrat 1,2,3,4 dhe A.1 diferencojnë në mënyrë eksplicite midis kërkesave që përmbahen në Direktivën Evropiane të karburanteve 98/70/EC (1), duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3), (4) dhe kërkesa të tjera.
- Kërkesat specifike lidhur me kufizimin e përdorimit të tricarbonylit të manganezit methylcyclopentadienyl (MMT) janë përfshirë siç kërkohen nga KE.
- Përderisa futja e 10% (V/V) e etanolit në benzinë pa plumb ka një ndikim në rafineri dhe në proceset e përzierjes, është konsideruar një përditësim i karakteristikave të distilimit dhe është paraqitur një Tabelë e re 3 me nivelet pak të përshtatura të avullueshmërisë (E70, E100 dhe VLI). Puna është ende në vijim për të gjeneruar të dhëna që do të mbështesnin idenë se këto ndryshime nuk ndikojnë aspektet e ngarjes së makinave në fillimin e të ftohtit dhe në mot të nxehtë. Për këto përditësime është rënë dakord paraprakisht dhe mund të rishikohen varësisht nga çështjet që lidhen me karburantet në treg.
- Janë dhënë specifikime të mëtejshme duke përfshirë pasqyra të ndara mbi gradën e benzinës pa plumb për makinat e vjetra që nuk janë autorizuar të punojnë me

## **EN 228:2012 (E)**

benzinë pa plumb me përmbajtje të lartë karburanti bio (biofuel). Paralelisht është përgatitur një CEN/TR që synon dhënien e udhëzimeve mbi përzierjen oksigjenate (5).

- Sqarime të mëtejshme se si të përcaktohet toleranca e presionit të avullit për benzinën pa plumb që përmban etanol të lejuar në treg në rrethana përjashtuese janë dhënë në Aneksin A. Është sqaruar numri i saktë i pikëve dhjetore për tolerancën (4).
- Janë futur disa metoda prove të reja ose të rishikuara. Direktiva Evropiane e karburanteve 98/70/EC (1), duke përfshirë Amendamentet e saj (2), (3), (4) u referohet metodave të provës në EN228:2004, me kërkesën që do të tregohen metoda analitike të përditësuara për të dhënë së paku të njëjtën saktësi dhe së paku të njëjtën përpikëri si metodat që ato zëvendësojnë.
- Heqja e kuotës prej 50mg/kg me përmbajtje sulfuri.
- Referencë ndaj specifikimeve të rishikuara të etanolit EN15376

Sipas Rregulloreve të Brendshme CEN/CENELEC, këtë Standard Evropian janë të detyruara të implementojnë organizatat kombëtare të standardeve të vendeve të mëposhtme: të Austrisë, Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Spanjës, Suedisë, Zvicrës, Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

## **EN 228:2012 (E)**

### **1. Fusha e shtrirjes**

Ky Standard Evropian specifikon kërkesat dhe metodat e provës për benzinën pa plumb për tregtim dhe shpërndarje. Ajo është e aplikueshme për benzinën pa plumb për përdorim në mjetet me motor benzine të projektuara për të punuar me benzinë pa plumb.

Ky Standard Evropian specifikon dy tipe të benzinës pa plumb: një tip me një përmbajtje oksigjeni maksimum prej 3,7% (m/m) dhe një përmbajtje etanoli maksimumi prej 10,0% (V/V) në Tabelën 1 dhe një tip që synohet për makina më të vjetra që nuk janë autorizuar të punojnë me benzinë pa plumb me një përmbajtje të lartë karburanti bio (biofuel), me një përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2,7% (m/m) dhe një përmbajtje etanoli maksimum prej 5,0% (V/V) në Tabelën 2.

SHËNIM 1: Të dy tipet janë bazuar në kërkesat e Direktivës Evropiane (3), (4)

SHËNIM 2: Për qëllimet e këtij Standardi Evropian termat “% (m/m)” dhe “% (V/V)” përdoren për të përfaqësuar respektivisht fraksionin e masës  $\mu$ , dhe fraksionin e volumit,  $\phi$ .

## 2. Referencat normative

Dokumentet e mëposhtme, tërësisht ose pjesërisht, referohen në mënyrë normative në këtë dokument dhe janë të domosdoshme për aplikimin e tij. Për referencat e datuara aplikohet vetëm botimi i cituar. Për referencat e padatuara aplikohet botimi më i fundit i dokumentit të referuar (duke përfshirë edhe amendamentet).

EN 237:2004, *Produkte të lëngshme naftë – Benzinë – Përcaktimi i përqendrimeve të ulta të plumbit me spektrometër absorbimi atomik*

EN 238:1996/A1:2003, *Produkte të lëngshme naftë – Benzinë – Përcaktimi i përmbajtjes së benzolit me spektrometër me rreze infra të kuqe*

EN 1601:1997<sup>4</sup>, *Produkte të lëngshme naftë – Benzinë pa plumb – Përcaktimi i përbërjeve organike të oksigjenuara dhe i përmbajtjes së lidhur totalisht dhe organikisht me oksigjenin me kromatograf gazi (O-FID)*

EN 12177:1998, *Produkte të lëngshme naftë – Benzinë pa plumb – Përcaktimi i përmbajtjes së benzolit me kromatograf gazi*

### **EN 228:2012 (E)**

EN 13016-1:2007, *Produkte të lëngshme naftë – Presion avulli – Pjesa 1: Përcaktimi i presionit të avullit me ajër të ngopur (ASVP) dhe i ekuivalentit të përlllogaritur të presionit të avullit të thatë(DVPE)*

EN 13132:2000, *Produkte të lëngshme naftë – Benzinë pa plumb – Përcaktimi i përbërjeve organike të oksigjenuara dhe i përmbajtjes së lidhur totalisht dhe organikisht me oksigjenin me kromatograf gazi duke përdorur ndryshimin e kolonës*

EN 14275:2003<sup>5</sup>, *Karburante automjetesh – Vlerësimi i cilësisë së karburantit benzinë dhe diezel – Testimi i mostrave nga pompat e pikave të shitjes me pakicë dhe shpërndarësit e karburantit në pika tregtare.*

EN 15376:2011, *Karburante automjetesh– Etanol si një komponent përzierjeje për benzinë – Kërkesa dhe metoda testimi.*

EN 15553:2007, *Produkte naftë dhe materiale të lidhura me të– Përcaktimi i tipeve të hidrokarboneve – Metoda e ndajthithjes me indikator fluoreshent*

EN 16135:2011, *Karburante automjetesh – Përcaktimi i përmbajtjes së manganezit në benzinën pa plumb – Metoda spektrometrike e thithjes atomike të flakës (FAAS)*

---

<sup>4</sup> Nën rishikim

<sup>5</sup> Nën rishikim

EN 16136:2011, *Karburante automjetesh – Përcaktim i përmbajtjes së manganezit në benzinën pa plumb – Metoda spektrometrike e emetimit optik të plazmës së çiftuar në mënyrë induktive (ICP OES)*

EN ISO 2160:1998, *Produkte naftë – Gërryeshmëria ndaj bakrit – Test rripi bakri (ISO 2160:1998.)*

EN ISO 3170:2004, *Produkte naftë – Testimi manual i mostrës (ISO 3170:2004).*

EN ISO 3171:2011, *Produkte naftë – Testimi i mostrës me tubacion automatik (ISO 3171:1988).*

EN ISO 3405:2011, *Produkte naftë – Përcaktimi i karakteristikave të distilimit në presion atmosferik (ISO 3405:2011)*

EN ISO 3675:1998, *Produkte naftë të papërpunuar dhe naftë të lëngshme – Përcaktim laboratorik i densitetit – Metoda me hidrometër (ISO 3675:1998)*

EN ISO 4259:2006, *Produkte naftë – Përcaktimi dhe aplikimi i të dhënave të sakta lidhur me metodat e testit (ISO 4259:2006)*

#### **EN 228:2012 (E)**

EN ISO 5163:2005<sup>6</sup>, *Produkte naftë – Përcaktimi i karakteristikave të goditjes së karburanteve të makinave dhe aviacionit – Metoda e makinave (ISO 5163:2005)*

EN ISO 5164:2005<sup>7</sup>, *Produkte naftë – Përcaktimi i karakteristikave të goditjes së karburantit të makinave – Metoda e kërkimit (ISO 5164:2005)*

EN ISO 6246:1997, *Produkte naftë – Përmbajtja e ngjitësit/gomës në karburantet e distiluara lehtë dhe mesatarisht – Metoda e avullimit reaktiv (ISO 6246:1995)*

EN ISO 7536:1996, *Produkte naftë – Përcaktimi i stabilitetit oksidues të gazolinës – Metoda e induksionit periodik (ISO 7536:1994)*

EN ISO 12185:1996, *Produktet e naftës dhe të naftës së papërpunuar – Përcaktimi i densitetit – Metoda me tubin lëkundës në formë U-je. (ISO 12185:1996)*

EN ISO 13032:2012, *Produkte naftë – Përcaktimi i përqendrimit të ulët të sulfurit në karburantet e automjeteve – Metoda spektrometrike fluoreshente me rreze X energji-shpërndarëse. (ISO 13032:2012)*

EN ISO 20846:2011, *Produkte naftë – Përcaktimi i përmbajtjes së sulfurit në karburantet e automjeteve – Metoda fluoreshente me rreze ultraviolet. (ISO 20846:2011)*

---

<sup>6</sup> Nën rishikim

<sup>7</sup> Nën rishikim

EN ISO 20884:2011, *Produkte nafte – Përcaktimi i përmbajtjes së sulfurit në karburantet e automjeteve – Spektrometri fluoreshente me rreze shpërndarëse X të valëve të gjata. (ISO 20884:2011)*

EN ISO 22854:2008<sup>8</sup>, *Produkte të lëngëta nafte – Përcaktimi i tipeve të hidrokarbureve dhe oksigjenateve në gazolinën për makinë-automjet – Metoda kromatografike shumëdimensionale me gaz. (ISO 22854:2008).*

### **3. Marrja e mostrave**

Mostrat duhet të merren siç përshkruhen në EN ISO 3170 ose EN ISO 3171 dhe/ose në përputhje me kërkesat e standardeve apo rregulloreve kombëtare për provën me mostër të benzinës pa

#### **EN 228:2012 (E)**

plumb. Kërkesat kombëtare duhet të parashtrohen në hollësi ose do t'iu referohet me referencë në një aneks kombëtar ndaj këtij Standardi Evropian.

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e disa nga metodat e provës të referuara në këtë Standard Evropian, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përputhshmërisë me çfarëdo udhëzimi mbi kontejnerët e testimit të mostrave, të cilat janë përfshirë në standardin e metodave të testit.

Është thelbësore që për testimin e mostrave të benzinës pa plumb, kontejnerët që përdoren për të marrë dhe ruajtur mostrat përpara provës të mos jenë të kontaminuara, sidomos me plumb dhe/ose sulfur.

### **4. Markerimi i pompave**

Informacioni që duhet markeruar në pompat shpërndarëse që përdoren për shpërndarjen e benzinës pa plumb dhe dimensionet e etiketave duhet të jenë në përputhje me kërkesat apo rregulloret e standardeve kombëtare për markerimin e pompave të benzinës pa plumb. Kërkesa të tilla duhet të parashtrohen në hollësi ose do t'iu referohen referencave në aneksin kombëtar ndaj këtij Standardi Evropian.

Etiketimi duhet të jetë qartësisht i dukshëm lehtësisht i lexueshëm dhe i dukshëm nëçdo pikë ku benzina pa plumb me shtesat metalike është e disponueshme për konsumatorët. Etiketa duhet të përmbajë: “Përmban shtesa metalike” në gjuhën(t) kombëtare dhe do të shtrihet në Aneksin Kombëtar të këtij dokumenti.

Është e rekomandueshme gjithashtu që markerimi shtesë i pompës të aplikohet për shpërndarjen e benzinës pa plumb që përmban oksigjenat të lartë (me një përmbajtje oksigjeni maksimum 3,7% (m/m) dhe/ose oksigjenate të ulëta (me një përmbajtje oksigjeni maksimum 2,7% (m/m).

---

<sup>8</sup> Nën rishikim

Për benzinën pa plumb që përmban oksigjenate të larta, markerimi i pompës do të konsistojë në simbole vizuale lehtësisht të njohshme që:

- a) Ti identifikojë benzinën pa plumb me përputhje me EN 228
- b) Të specifikojë RON-in dhe
- c) Të identifikojë që benzina pa plumb përmban oksigjenate të larta (në këtë rast simboli i rekomanduar është "E 10").

Për benzinën pa plumb që përmban oksigjenate të ulëta, markerimi i pompës do të konsistojë në simbole vizuale që njihen lehtësisht që:

- d) Të identifikojë benzinën pa plumb në përputhje me EN 228
- e) Të specifikojë RON-in dhe

### **EN 228:2012 (E)**

- f) Të identifikojë pëlqimin e Shtetit Anëtar dhe të jetë e pasqyruar në një Aneks Kombëtar në këtë dokument se benzina pa plumb përmban oksigjenate të ulëta.

Pompat shpërndarëse për benzinën pa plumb me oksigjenate të larta ose të ulëta mund të markerohen gjithashtu me tekst në gjuhën(t) kombëtare sipas pëlqimit të Shtetit Anëtar duke përshkruar karakteristikat e benzinës pa plumb dhe të gjitha të tilla kërkesa do të parashtrohen me hollësi ose do të referohen në një Aneks Kombëtar në këtë dokument.

## **5 Kërkesat dhe metodat e provës**

### **5.1 Etanoli**

Benzina pa plumb mund të përmbajë deri në 10.0% (V/V) të etanolit në përputhje me EN 15376.

Kur etanoli përdoret si komponent përzierës, ai mund të përmbajë denatyrante në qoftë se kërkohen nga rregulloret Evropiane dhe kombëtare. Këto denatyrante lejohen me kusht që të sigurojnë se ato nuk shkaktojnë efekte anësore të dëmshme për makinat dhe sistemet e distribucionit të karburantit.

**SHËNIM:** Këshilla të mëtejshme për trajtimin dhe oksigjenatet përzierëse në tërësi mund të gjenden në (6). Udhëzime të mëtejshme mbi oksigjenatet përzierëse në përputhje me kërkesat e 2009/30EC janë dhënë në CEN:TR 16435(5).

Është i rekomandueshëm një regjistër për gjurmimin e origjinës biologjike. Për përcaktimin e origjinës biologjike të etanolit, një alternativë është përcaktimi i moshës, e cila bazohet në prishjen beta(minus) të izotopit të karbonit radioaktiv C14. Kjo metodë (9) konsiderohet shumë e lodhshme për testime të shpeshta, por mund të konsiderohet një instrument i dobishëm për të përcaktuar rastet kur kontestohet qasja e gjurmës së auditit.

### **5.2 Ngjyrat dhe shenjat**

Përdorimi i ngjyrave dhe shenjave lejohet me kusht që të sigurojnë se ato nuk shkaktojnë efekte të dëmshme anësore për makinat dhe sistemet e distribucionit të karburanteve.

### **5.3 Shtesat**

#### **5.3.1 Të përgjithshme**

Me qëllim që të përmirësohet cilësia e performancës lejohet përdorimi i shtesave. Për të ndihmuar në mënjanimin e përkeqësimit të ngarjes dhe qëndrueshmërinë e mbajtjes nën kontroll të emetimeve, rekomandohen në sasi të përshtatshme shtesa në karburant por të tilla që nuk kanë efekte të dëmshme anësore të njohura,. Mund të përdoren gjithashtu mjete të tjera teknike me efekte të barasvlershme.

#### **EN 228:2012 (E)**

**KUJDES – benzina pa plumb do të jetë e lirë nga çdo papastërti apo kontaminim që mund ta bëjë karburantin të papranueshëm për përdorim në makinat me motor benzine të projektuara për të punuar me benzinë pa plumb.**

SHËNIM Nuk janë identifikuar dhe nuk janë zhvilluar akoma metoda për provën e tendencave të formimit të depozitave të përshtatshme për qëllime kontrolli rutinë.

#### **5.3.2 Fosfori**

Me qëllim që të ruajnë sistemet katalitike të automjeteve, përzierjet që përmbajnë fosfor nuk do t'i shtohen benzinës pa plumb.

#### **5.3.3 Trikarbonil Manganezi Metilciklopentadienyl (MMT)**

Kur përdoret Trikarbonil Manganezi Metilciklopentadienyl (MMT), kërkohet një etiketë specifike (shih klauzolën 4).

MMT është një shtesë metalike që mund të përdoret në benzinën pa plumb. Prania e MMT në benzinën pa plumb do të kufizohet në 6mg manganezi për litër nga 1 Janari 2011. Kufizimi do të jetë 2 mg për litër nga 1 Janari 2014.

SHËNIM Këto kërkesa janë objekt rishikimi pas vlerësimeve nga Komisioni Evropian.

### **5.4 Kërkesa të përgjithshme aplikimi dhe metoda testimi**

Kur testohet me metodat e treguara në Tabelat 1,2,3 dhe 4, benzina pa plumb, sipas përmbajtjes maksimum të oksigjenit të saj, duhet të jetë në përputhje me kufizimet e specifikuar respektivisht në Tabelat 1,2,3 dhe 4.

Shtetet Anëtare mund të vendosin të vijojnë për të lejuar daljen në treg të benzinës pa plumb të shkallës së rregullt. Kjo shkallë e ndarë duhet të jetë në përshtatje me të gjitha kërkesat e

parashtruara në Tabelat 1,2,3 dhe 4 të këtij Standardi Evropian, me përjashtim të një numri minimum oktanësh të makinave (MON) prej 81 dhe një numri minimum oktanesh kërkimi (RON) prej 91. Kërkesat dhe metodat e provës pasqyrohen pastaj në një Aneks Kombëtar në këtë dokument.

Metodat e provës të përfshira si referenca normative në këtë Standard Evropian, kur përditësohen, duhet t'iu jepet së paku e njëjta saktësi dhe së paku i njëjti nivel përpikërie si metodat që ato zëvendësojnë.

**SHËNIM** Për informacion të mëtejshëm mbi kontaminimin parandalues në zinxhirin e furnizimit ose për kontaminimin e ndërsjellët, është e këshillueshme të kontrollohet CEN/TR

**EN 228:2012 (E)**

15367, Pjesët 2 dhe 3 respektivisht (7,8). Një metodë përcaktimi për komponentët me zierje të lartë në benzinën pa plumb është nën zhvillim e sipër nga CEN.

**Më poshtë, Tabela 1- Kërkesa dhe metoda prove për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 3.7% (m/m)**



Dokumentat Standarde të Tenderit

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi <sup>a</sup> (Shih 2. Referenca normative)
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0 35,0	EN 15553 EN ISO 228 54
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		3,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854

Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)			EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Methanol g			3,0	
- Etanol h			10,0	
- Alkool Iso-propil			12.0	
- Alkol Iso-butyl			15.0	
- Alkool Tert-butyl			15.0	
- Eterë (5 ose më shumë atome C)			22.0	
- Oksigjenate të tjera			15.0	
SHËNIM: Kërkesat e theksuara me <b>bold</b> i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)				
<p>(a) Shih gjithashtu 5.7.1</p> <p>(b) një korrekim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2</p> <p>(c) Shih gjithashtu 5.7.2</p> <p>(d) Shih gjithashtu 5.3.3</p> <p>(e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti</p> <p>(f) Një studim CEN gjendet në EN ISO 22854 i aplikueshëm për analizat e mostrave që kanë një përmbajtje oksigjeni prej maksimumi 3.7% (m/m).</p> <p>(g) Do të shtohen agjentë stabilizues</p> <p>(h) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen.</p> <p>(i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 3</p> <p>(k) Metodatat e cituara të testit nuk kanë një parashtrësë precizioni për një përmbajtje oksigjeni mbi 3 (m/m). Bazuar në të dhëna kompeticioni nga gjashtë vjetët e fundit, CEN/TC 19 pranon një vlerë riprodhimi mesatare të <math>R=0.37</math> për të gjitha metodatat e testit.</p>				

**Në vijim, Tabela 2- Kërkesa dhe metoda testi për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2.7% (m/m)**

Vetitë	Njësitë Dokumentat Standarde të Tenderit	Kufizimet		Metoda Testi <sup>a</sup>
		Min	Max	
				(Shih Referenca normative) 2.
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0 35,0	EN 15553 EN ISO 228 54
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854

Përmbajtja e oksigjenatit c - Methanol - Etanol g	% (V/V)		3,0 5,0	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Alkool Iso-propil h - Alkol Iso-butyl h - Alkool Tert-butyl h - Eterë (5 ose më shumë atome C) h - Oksigjenate të tjera hi			Përzierje volumi e kufizuar në 2.7% (m/m) përmbajtja max. e oksigjenit	
SHËNIM: Kërkesat e theksuara me <b>bold</b> i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)				
(a) Shih gjithashtu 5.7.1 (b) një korrektim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2 (c) Shih gjithashtu 5.7.2 (d) Shih gjithashtu 5.3.3 (e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti (f) Do të shtohen agjentë stabilizues (g) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen. (h) Përmbajtja e oksigjenit të benzinës së pastër pa plumb nuk do të kapërcej 2,7% (m/m). Një CEN/TR mbi përzierjen oksigjenate është në përgatitje e sipër. (i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 4				

## 5.5. Kërkesat që varen nga klima dhe metodat e provës

### 5.5.1 Toleranca e ujit

Duke u nisur nga potenciali i njohur i disa karburanteve për të thithur ujë furnizuesit do të sigurojnë që asnjë veçim uji nuk duhet të ndodhë gjatë ndryshimeve të kushteve klimaterike në shtetin e interesuar. Kur ka rrezik veçimi të ujit, duhen inkorporuar shtesa antikorrozion (kundërgërryerjes).

**SHËNIM:** Për informacion të mëtejshëm për parandalimin e kontaminimit nga uji ose nga sedimenti që mund të ndodhë në zinxhirin e furnizimit ose për kontaminimin e ndërsjellët, është e këshillueshme të kontrollohet CEN/TR 15367, respektivisht Pjesët 2 dhe 3 (7,8).

### 5.5.2 Kërkesa e avullueshmërisë

Me qëllim që të përmbushen kërkesat e ngarjes së makinave në të ftohtë dhe në të nxehtë sipas kushteve sezonale dhe gjeografike Evropiane, janë përcaktuar dhjetë klasa avullueshmërie të cilat jepen në tabelën 3,4 dhe ilustrohen në figurën 1 dhe figurën 2. Çdo vend do të specifikojë në një Aneks Kombëtar në këtë Standard Evropian për secilin tip të benzinës pa plumb se cila nga këto dhjetë klasa avullueshmërie zbatohet dhe gjatë cilës periudhë të vitit për rajone të caktuara të vendit.

Klasa a do të aplikohet gjatë verës duke u nisur jo më vonë se 1 Maj dhe duke përfunduar jo më përpara 30 Shtatorit. Në vendet me temperatura të ulëta ambienti gjatë verës siç përcaktohet në (3) do të aplikohet klasa b gjatë verës duke filluar jo më vonë se 1 Qershori dhe duke përfunduar jo më përpara se 31 Gushti.

Çdo vend do të aplikojë një ose më shumë klasa avullueshmërie me VLI (klasat C1, D1, E1 ose F1) për periudhat tranzitore në secilën anë të verës. Çdo periudhë tranzitore duhet të jetë në një minimum prej katër javësh. Kur periudhat tranzitore gjykohen kritike periudha(t) e tranzicionit kritik do të jenë në një minimum prej tetë javësh. Gjatë periudhës që mbetet do të aplikohen një ose më shumë klasa dimri me ose pa VLI (klasa C, C1, D, D1, E, E1, F ose F1).

Aplikimi i tolerancës së presionit të avullit të lejuar për benzinën pa plumb që përmban bioetanol është i kufizuar në vendet që kanë përmbushur kërkesat sikurse parashtrihen në (3).

Kur një tolerancë e tillë është lejuar dhe aplikuar do të bëhen referencat e përshtatshme në një Aneks Kombëtar në këtë Standard dhe toleranca do të aplikohet në Aneksin a.

**Tabela 3 – Klasat e avullueshmërisë për benzinën pa plumb me një përmbajtje oksigjeni maksimum prej 3,7% (m/m).**

Vetitë	Njësitë	Kufizimet						Metoda e provës (Shih referencat normative)
		Klasa A	Klasa B	Klasa C/C1	Klasa D/D1	Klasa E/E1	Klasa F/F1	
<b>Presioni i Avullit (VP)</b>	kPa, min <b>kPa,</b> <b>max</b>	45,0 <b>60,0</b>	45,0 <b>70,0</b>	50,0 80,0	60,0 90,0	65,0 95,0	70,0 100,0	EN 13016-1 b
Përqindja e avulluar në 70 C°, E70	% (V/V) <b>min %</b> (V/V) <b>max</b>	22,0 50,0	22,0 50,0	24,0 52,0	24,0 52,0	24,0 52,0	24,0 52,0	EN ISO 3405
<b>Përqindja e avulluar në 100 C°, E100</b>	% (V/V) <b>min %</b> (V/V) <b>max</b>	<b>46,0</b> 72,0	<b>46,0</b> 72,0	<b>46,0</b> 72,0	<b>46,0</b> 72,0	<b>46,0</b> 72,0	<b>46,0</b> 72,0	EN ISO 3405
<b>Përqindja e avulluar në 150 C°, E150</b>	% (V/V) <b>min</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	EN ISO 3405
Pika fundore e valimit FBP	C°, max	210	210	210	210	210	210	EN ISO 3405
Mbetje distilimi	% (V/V), max	2	2	2	2	2	2	EN ISO 3405
Indeksi i bllokimit të avullit (VLI) (10VP+7E70)	Index, max	-	-	C	D	E	F	
Indeksi i bllokimit të avullit (VLI) (10VP+7E70)	Index, max			C1 1064	D1 1164	E1 1214	F1 1264	

**SHËNIM** Kërkesat e theksuara me **bold** i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1), duke përfshirë amendamentet në vijim (2),(3),(4)

<sup>a</sup> Shih gjithashtu 5.7.1.

b Do të raportohet Ekuivalenti i Presionit të Avullit të Thatë (DVPE)

**EN 228:2012 (E)**

**Tabela 3 – Klasat e avullueshmërisë për benzinën pa plumb me një përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2,7% (m/m).**

Vetitë	Njësitë	Kufizimet						Metoda e provës <sup>a</sup> (Shih referencat normative) <sup>2</sup>
		Klasa A	Klasa B	Klasa C/C1	Klasa D/D1	Klasa E/E1	Klasa F/F1	
<b>Presioni i Avullit (VP)</b>	kPa, min <b>kPa,</b> max	45,0 <b>60,0</b>	45,0 <b>70,0</b>	50,0 80,0	60,0 90,0	65,0 95,0	70,0 100,0	EN 13016-1 b
Përqindja e avulluar në 70 C°, E70	% (V/V) <b>min %</b> (V/V) <b>max</b>	20,0 48,0	20,0 48,0	22,0 50,0	22,0 50,0	22,0 50,0	22,0 50,0	EN ISO 3405
<b>Përqindja e avulluar në 100 C°, E100</b>	% (V/V) <b>min %</b> (V/V) <b>max</b>	<b>46,0</b> 71,0	<b>46,0</b> 71,0	<b>46,0</b> 71,0	<b>46,0</b> 71,0	<b>46,0</b> 71,0	<b>46,0</b> 71,0	EN ISO 3405
<b>Përqindja e avulluar në 150 C°, E150</b>	% (V/V) <b>min</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	<b>75,0</b>	EN ISO 3405
Pika fundore e valimit FBP	C°, max	210	210	210	210	210	210	EN ISO 3405
Mbetje distilimi	% (V/V), max	2	2	2	2	2	2	EN ISO 3405



Indeksi i bllokimit të avullit (VLI) (10VP+7E70)	Index, max	-	-	C	D	E	F	
Indeksi i bllokimit të avullit (VLI) (10VP+7E70)	Index, max			C1	D1	E1	F1	
				1050	1150	1200	1250	
SHËNIM Kërkesat e theksuara me <b>bold</b> i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1), duke përfshirë amendamentet në vijim (2),(3),(4)								
<sup>a</sup> Shih gjithashtu 5.7.1.								
b Do të raportohet Ekuivalenti i Presionit të Avullit të Thatë (DVPE)								

## EN 228:2012 (E)

### 5.6 Raportimi i oktanit

- Për të parandaluar ndonjë keqinterpretim në rezultatet e raportuara, rekomandohet raportimi i mëposhtëm:

- RON<sub>m</sub>, që është numri i Matur i Kërkimit të Oktanit sipas EN ISO 5164

- MON<sub>m</sub>, që është numri i Matur i Oktanit të Makinës sipas EN ISO 5163

- RON dhe MON që janë respektivisht vetitë e oktanit të Makinës dhe të Kërkimit, do të raportohen pas ndreqjes të RON<sub>m</sub> dhe MON<sub>m</sub> sipas formulës (1) dhe (2):

$$\text{RON} = \text{RON}_m - 0.2 \quad (1)$$

$$\text{MON} = \text{MON}_m - 0.2 \quad (2)$$

### 5.7 Saktësime dhe diskutime

#### 5.7.1 Zgjidhja e konflikteve

Të gjitha metodat e provës të referuara në këtë Standard Evropian përfshijnë një deklaratë preçize. Në raste konflikti, do të përdoren procedurat për zgjidhjen e tij dhe interpretimi i rezultateve do të bazohet në precizionin e metodës së provës të përshkruar në EN ISO 4259.

#### 5.7.2 Metodat e testit të arbitrazhit

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me numrin e oktanit të makinës dhe numrin e oktanit të kërkimit, do të përdoren respektivisht EN ISO 5163 dhe EN ISO 5164. Për përcaktimin e MON

dhe RON mund të përdoren gjithashtu metodat alternative që tregohen në Tabelën 1 dhe Tabelën 2, duke u siguruar që këto metoda të zenë fill nga një seri e metodave të njohura dhe të kenë një deklaram për precizionin e vlefshëm që rrjedh sipas EN ISO 4259, e cila demonstroi precizion së paku të barabartë me atë të metodës së referuar. Rezultati i provës, kur përdoret një metodë alternative, do të ketë gjithashtu një marrëdhënie të demonstrueshme përkundrejt rezultatit të përfutur nga përdorimi i metodës së referuar.

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me densitetin, do të përdoret EN ISO 12185

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me përmbajtjen e sulfurit, do të përdoren ose EN ISO 20846 ose EN ISO 20884.

Në raste mosmarrëveshjeje për përmbajtjen e tipit të hidrokarbonit, do të përdoret EN ISO 22854 {shiko (10)}.

#### **EN 228:2012 (E)**

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me përmbajtjen e benzolit, EN 238 nuk mund të përdoret si metodë diskutimi.

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me përmbajtjen e oksigjenit, EN 13132 nuk mund të përdoret si metodë diskutimi.

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me përmbajtjen e metanolit, do të përdoret EN 1601.

**SHËNIM:** EN 1601 aplikohet për mostrat që përmbajnë > 15% (V/V) eter duke përdorur një shkallë hollimi për të ulur sasinë e eterit në një vlerë poshtë 15% (V/V).

Në raste mosmarrëveshjeje lidhur me përmbajtjen e oksigjenit do të përdoret EN ISO 22854.

#### **EN 228:2012 (E)**

#### **Aneksi A**

(Normativ)

#### **Toleranca e presionit të avullit**

##### **A.1 Toleranca e lejuar e presionit të avullit**

Toleranca e lejuar e presionit të avullit për përmbajtjen e ndërmjetme të etanolit midis vlerave të listuara në Tabelën A.1 do të përcaktohet nga një interpolacion në vijë të drejtë midis përmbajtjes së etanolit që gjendet menjëherë sipër dhe atij që gjendet menjëherë poshtë vlerës së ndërmjetme të përcaktuar me metodat e treguara në tabelën A.1

**Tabela A.1 – Tolerancat e lejuara të presionit të avullit për benzinën pa plumb me përmbajtje bioetanol.**

<b>Përmbajtja e etanolit EN 1601 – EN 13132 –EN ISO 22854<sup>a</sup> % (V/V)</b>	<b>Toleranca e lejuar e presionit të avullit EN 13016 – 1 kPa</b>
<b>0</b>	<b>0</b>
<b>1.0</b>	<b>3.7</b>
<b>2.0</b>	<b>6.0</b>
<b>3.0</b>	<b>7.2</b>
<b>4.0</b>	<b>7.8</b>
<b>5.0</b>	<b>8.0</b>
<b>6.0</b>	<b>8.0</b>
<b>7.0</b>	<b>7.9</b>
<b>8.0</b>	<b>7.9</b>
<b>9.0</b>	<b>7.8</b>
<b>10.0</b>	<b>7.8</b>
<sup>a</sup> Shih gjithashtu 5.7.2	

**EN 228:2012 (E)**

**A.2 Udhëzime për kontrollin e përputhshmërisë me tolerancën e lejuar**

Me qëllim që të merren mostra korrekte për përputhshmërinë e presionit të avullit do të përdoret EN 14275.

Për të verifikuar përputhshmërinë me tolerancën e lejuar do të ndiqet qasja e mëposhtme.

- 1) Matet përmbajtja e etanolit në përputhje me metodat e provës të listuara në tabelën A.1.
- 2) Merr tolerancat e rrumbullakosura që i korrespondojnë masës së përmbajtjes së etanolit.
- 3) Apliko tolerancën në limitet e presionit maksimum të avullit sipas EN 228 të Klasës A në klasat e avullimit (60.0 kPa) siç përcaktohet në Tabelën 3 dhe përfto një limit të ri. tolerance.
- 4) Kryej matjen e presionit të avullit në përputhje me EN 13016-1, duke përdorur procedurë konteneri 1 1.
- 5) Krahaso rezultatet e përftuara në pikat 3 dhe 4

- 6) Interpretimi i rezultateve dhe verifikimi i përputhshmërisë do të kryhet sipas EN ISO 4259.

OE duhet të jetë i pajisur dhe të paraqese Lejen e Tregtimit të Karburanteve në përputhje me Ligjin Nr. 8450 dt.24.02.1999 (me ndryshimet përkatëse) « Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre », të shoqëruar me Autorizimin për Lejen e Tregtimit të Karburanteve, në zbatim të Ligjit Nr. 8450 dt. 24.02.1999 (me ndryshimet përkatëse) « Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ».

- **OE duhet të paraqese flete-analize leshuar nga organi kompetent (IQT) që verteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që OE tregeton, sipas standardeve të percaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të marre jo më parë se 30 (tridhjetë) DITE KALENDARIKE nga data e dorëzimit si dhe certifikatën e origjinës dhe cilësisë së mallit (Flete analize për karburant gazoil 10 ppm dhe për benzine pa plumb).**

OE duhet të sigurojë dhe garantojë furnizimin me karburant sipas standardeve shtetërore në fuqi **S SH EN 590 : 2013** (Diesel) dhe **S SH EN 228:2012** (benzinë pa plumb), me leng, karta elektronike ose tollona (bileta) të vlefshëm në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës) të vendosura në qytetet e mëposhtme , në të cilat ushtrojnë aktivitetin Njësitë dhe Agjensitë e AK :

Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Krujë, Lushnjë, Berat, Kucovë, Skrapar, Fier, Vlorë, Patos, Ballsh, Gjirokastër, Sarandë, Tepelene, Permet, Korçë, Pogradec, Bilisht, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Gramsh, Librazhd, Shkodër, Koplak , Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Bulqizë, Rubik, Diber, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has.

- **Afatet e lëvrimit: Malli do të ofrohet për gjatë gjithë vitit me karta elektronike, tollona ( bileta ), sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme. Kërkesa do të jetë në formën e kërkesës zyrtare me shkrim ose në mënyrë elektronike (email).**

Sasia e karburantit do të jetë e disponueshme për t'u terhequr nëpërmjet tollonave ose e kredituar në kartat elektronike në të gjitha pikat e karburantit të shoqërisë. Furnizimi të kryhet sipas nevojave, në llogarinë elektronike të AK ose me tollona bileta me prerje 10 dhe 20 litra. OE duhet të ofrojë një aplikacion elektronik për kreditimin në kohë reale të sasive të karburantit me mënyrë elektronike për çdo mjet të AK. Kartat elektronike të furnizimit duhet të ofrohen nga Operatori Ekonomik për Autoritetin Kontraktor pa kosto shtesë sa herë që të jetë e nevojshme. Kërkesat për pajisje me karte elektronike furnizimi do të behen nga përfaqësuesi i AK me shkresë zyrtare ose email.

Në qoftë se ndryshon forma e tollonit bilete, ato që janë në përdorim duhet të zëvendësohen.

**Tollonat bilete te jene me firmen, vulen e furnizuesit, dhe te njejten logo me pikat e karburnatit, te jene te pajisur me ELEMENT SIGURIE, te jene te vlefshem per t'u perdorur gjate gjithë vitit 2019 dhe 2020, dhe te mund te perdoren ne te gjitha pikat e karburantit te furnizuesit.**

**TOLLONAT BILETE NUK DUHET TE JENE TE SKADUESHEM APO ME AFAT.**

Furnizimi i mjeteve te AK. do te behet cdo dite 24h/24h ne distributoret e Furnizuesit.

E drejta per te kerkuar fillimin e levrimit te karburanteve do te jete menjehere nga momenti i lidhjes se kontrates, por gjithmone sipas nevojave dhe kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Malli do te ofrohet, me tollona bilete ose duke kredituar llogarine elektronike te AK sipas nevojave OE duhet te furnizojë me karburant AK, levrimi i mallit do kryhet periodikisht me tollona bilete ose duke kredituar llogarine elektronike, faturat perkatese per cdo veprim do dorezohen ne magazinën qendrore prane AK.

Me paraqitjen e kerkeses nga AK kontraktuesi eshte i detyruar te furnizojë autoritetin kontraktor ne sasive korresponduese te tollonave ose te sasise elektronike duke perfshire ne cmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale qe ka shteti shqiptar.

**TOLLONAT BILETE DUHET TE JENE TE KONVERTUESHEM NE TE GJITHA PIKAT KU FURNIZUESI GARANTON FURNIZIMIN E ME KARBURANT.**

**KOHEZGJATJA E KONTRATES 12 MUAJ KALENDARIK.**

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: _____ Kuadër _____			Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>	
<b>01</b>	_____	_____	
<b>02</b>	_____	_____	
<b>03</b>	_____	_____	
<b>...</b>	_____	_____	

## Shtojca 12

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

- Gazoil D1 10 ppm: **1,461,000 Litra (Një million e katerqind e gjashtedhjetë e një mijë)**
- Benzinë pa plumb: **105,000 litra (Njëqind e pese mijë)**

**Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga nënshkrimi i kontrates, sipas kërkeses të OSHEE GROUP sh.a**

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>9</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>9</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
